

Për pajisjen me leje punimesh duhet të paraqisni pranë A.Rr.Sh-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kerkese me shkrim per nderhyrje ne aksin kombetar
- Planimetri të detajuar të segmentit ku mendoni të kryeni punimet.
- Detaje të prerjes tërthore të rrugës, ku te tregohet pozicionimi i kanalit kundrejt rruges dhe elementeve te saj, ose kur ka vepra arti, (ura, etj), menyra e kalimit ne to.
- Relacion teknik i detajuar i punimeve që do të kryhen. Te tregohen metodologjia e kryerjes se punimeve, makinerite qe perdoren, shtresat rrugore qe hiqen, zevendesimi i tyre, shoqëruar me trashesine e cdo shtrese, kohezgjatja e punimeve, grafiku i punimeve,
- Specifikimet teknike te materialeve te projektit, qe perdoren per shtresat.
- Te jepen koordinatat e pikes se fillimit dhe mbarimit te objektit, si dhe te gjatesive te nderhyrjeve ne asfalt, bankine, trotuar, vepra arti, etj.
- Preventiv i veçantë për punimet në trupin e rrugës ose pjesët përbërëse të saj, me zërat e punimeve sipas Manualit të vitit 2015. Per te gjithë zerat e punimeve, te paraqiten tabelat e volumeve.
- Plani i Menaxhimit të Trafikut për periudhën e ndërhyrjes.
- Azhornimi me rrjetin nëntokësor të segmentit ku kryhen punimet, si dhe te tregohet ne nje prerje terthore pozicionimi i linjes së projektit te propozuar, kundrejt linjave ekzistuese.
- Kopje të kontratës së Investitorit me kontraktorin.
- Kopje te kontrates se investitorit me mbikeqyresin e punimeve
- I gjithë materiali në CD

Pas shqyrtimit dhe miratimit të dokumentacionit, bëhen pagesat e mëposhtme:

- Garanci punimesh prej 10% të preventivit të punimeve në trupin e rrugës, e cila do të kthehet pas mbarimit të afatit të garancisë së punimeve dhe marrjes në dorëzim nga specialistët e A.Rr.Sh-së së bashku me specialistët e Drejtorisë së Rajonit Rrugor, të cilët do të ndjekin ecurinë e punimeve. 2 VJET
- Pagesë 10% e preventivit të punimeve për përdorimin e rrugës (e pakthyeshme). Kjo faturë merret pranë Sektorit te Mirembajtjes se Rrugeve.